



## Përmbajtja:

**-Grupet Analizuese Komunale-Vendet Publike**

**-Grupet Analizuese Komunale-Zhvillimi Ekonomik Lokal**

**-Webfaqja e Asociacionit**

**- Takimi i Këshillit të AKK-së më 18 Shkurt 2004**

**-Takimi me Z/PSSP Francesko Bastagli në lidhje me menagjimin epron[s private**

**- Lidhja me Këshillin e Evropës, Agjencionin e Demokracisë Lokale**

**-Hulumtimi mbi Standardet**

**-Vizita në komunat e Jesenicës dhe Kranjska Gorës në Slloveni**

**-Ri-përkthimi i Kartës Evropiane mbi Vetëqeverisjen Lokale**

**-AKK në përkrahje të petitionit për pengjet e pagjetura**

**-Vizita e Z. Lutfi Hazirit, Kryetarit të AKK-së në Bruksel**

**-Vizita e Asociacionit të Njësisë të Vetëqeverisjes Lokale të Maqedonisë**

# Buletini Informativ i Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK)

## Grupet Analizuese Komunale-Vendet Publike

Gjatë muajit Janar Grupet Analizuese Komunale kanë punuar në lidhje me vendet publike. Pas një varg takimesh që mbajti personeli i IFES-it me zyrtarë komunal, ata vizituan komunën e Deçanit si dhe të Gjakovës.

Në Deçan ata u njohën me sukseset që ka arritur komuna e Deçanit pa ndihmën e donatorëve.

Këtu vlen të përmendet rregullimi i sheshit në qendër të Deçanit. Për një kohë të gjatë qytetarët e Deçanit kanë jetuar në një qendër qyteti jotërheqëse dhe me mbingarkim të rrugës kryesore. Tani, kjo është zëvendësuar me një **vend publik** tërheqës në qendër me një rreth për të rregulluar qarkullimin e trafikut, trotuare, zona qëndrimi dhe parqe tërheqëse.

Në anën tjetër në Gjakovë stafi i IFES-it hasi në një rast mjaft prekës. Fshati Mejë i komunës së Gjakovës ka pësuar humbjen e 500 personave gjatë vitit 1990-2000.

Pikëllimi nga kjo është bërë edhe më i madh për shkak se nuk ka tokë për ndërtimin e një varreze të përshtatshme. Toka pranë që është e përshtatshme për tu përdorur është transferuar tek Agjencioni Kosovar i Mirëbesimit dhe mandati i tyre nuk i lejon ata ta lirojnë tokën. AKK – ja është duke kërkuar një rrugë përmes së cilës vendimi për përdorimin e tokës duhet të merr në konsideratë nevojat themelore sociale të banorëve të komunës.

Pas studimeve të rasteve komunale në lidhje me

vendet publike është përpiluar deklarata parimore e cila pret aprovimin nga Bordi i AKK-së.



Sheshi në qendër të Deçanit



Varrezat e Gjakovës

## Grupet Analizues Komunale - Zhvillimi Ekonomik

Si rrjedhojë e punës së këtij grupi dolën në pah çështjet të cilat kanë të bëjnë me zhvillimin ekonomik lokal nga këndvështrimi i shërbyesve civil dhe anëtarëve të Kuvendeve të Komunave të Kosovës .

Çështjet apo problemet më të rëndësishme të cilat komunat i theksuan gjatë punës së grupit kishin të bëjnë me problemet e lindura nga marrja prapa nga niveli qendror, respektivisht Ministria e tregëtisë dhe industrisë, e të drejtës së Komunave për regjistrimin e bizneseve, e drejtë kjo e cila u takonte më herët komunave. Sipas përfaqësuesve komunal deri sa regjistrimi i takonte nivelit komunal të gjitha palët ishin të kënaqura dhe si komuniteti i biznesit ashtu edhe komuna kishin një pasqyrë më të mirë rreth zhvillimeve ekonomike në komunat përkatëse.

Çështje tjetër me rëndësi e dalë nga puna e këtij grupi ishte ideja për formimin e një komisioni profesional ekonomik në nivel të Asociacionit të Komunave nga përfaqësues komunal. Detyrë e këtij komisioni do të jetë koordinimi i aktivitetëve ekonomike në nivelin lokal në mes të komunave të ndryshme.

Gjithashtu ky grup analizues u pajtua për formulimin e një dokumenti të quajtur “strategjia e parimeve të përbashkëta”, në mes të Qeverisë dhe Asociacionit të Komunave të Kosovës.

## Takimi i Këshillit të Asociacionit të Komunave të Kosovës më 18 shkurt 2004

Në muajin shkurt, pra më 18 Shkurt të vitit 2004 është mbjatur takimi i parë i Këshillit të Kryetarëve të Komunave të Kosovës në vitin 2004. Në këtë takim Z. Hysni Bajrami, drejtor i Departamentit për Administratë Lokale, Ministria e Shërbimeve Publike (MSHP) paraqiti punën e Ministrisë së SHP lidhur me përpilimin e Ligjit mbi vetë qeverisje lokale. Të pranishmit u pajtuan se ky ligj është shumë i rëndësishëm për Komunitet e Kosovës. Në vazhdim të këtij takimi u prezentuan deklarata parimore e grupeve

analizuese lidhur me Shërbimet publike dhe lidhur me Zhvillimin Ekonomik Lokal. Këshilli u pajtua që këto deklarata parimore të dërgohen nëpër Kuvende Komunale (KK) dhe pas diskutimit nëpër KK të bëhet aprovimi i tyre. Paga e kryetarëve dhe nënkryetarëve të Komunave ishte njëra ndër pikat e diskutuara në këtë takim. Propozimi i dalur nga AKK-ja u aprovua pas disa ndryshimeve. Këto ndryshime ishin lidhur me pagën e Kryetarit të KK të Prishtinës, diferenca e pagës së Kryetarëve dhe nënkryetarëve

të jetë 150 € dhe që liderëve të opozitës të mos ju paguhet pagë mujore.

Poashtu, u paraqitën disa nga projektet e AKK-së për këtë vit.

- Web-faqja e AKK-së,
- Hulumtimi mbi "Sa komunitet e Kosovës i kanë përmbushur Standardet e kërkuara nga Bashkësia ndërkombëtare",
- vizita në Slloveni e katër Kryetarëve të KK-ve të Kosovës si dhe
- përkrahja e AKK-së lidhur me mbledhjen e petitionit për personat e pagjetur janë disa nga projektet e AKK-së për këtë vit.



### Webfaqja e Asociacionit

Njëri ndër projektet e AKK-së për këtë vit është edhe krijimi i web-faqes për Asociacionin e Komunave të Kosovës. Ky projekt përkrahet financiarisht nga OSBE-ja, kurse implementues i këtij projekti është OJQ-ja vendore CPSR. Qëllimi i këtij projekti është rritja e transparencës së Komunitet ndaj qytetarëve, efikasiteti i komunikimit ndërkomunal si dhe kompjuterizimi i komunave të Kosovës. Qeverisja elektronike është shumë e rëndësishme për qytetarët e Kosovës si dhe për Komunitet e Kosovës.

### Takimi me z.Francesco Bastagli Z/PSSP në lidhje me menaxhimin e pronës komunale

Në Janar të vitit 2004 u mbajt mbledhja në mes të UNMIK-ut dhe AKK-së në lidhje me çështjet pronësore komunale në zyrën e Z/PSSP, Z. Francesco Bastagli.

Asociacioni i Komunave të Kosovës në Korrik të vitit 2003 i ka paraqitur me shkrim UNMIK-ut brengat në lidhje me çështjet pronësore. Historikisht, Komunitet kanë administruar mbi pronën shoqërore dhe e kanë bërë shpërndarjen e tyre nëpër etnitete, duke përfshirë këtu edhe ndërmarrjet shoqërore. AKK-ja në këtë takim ka paraqitur opinionet e anëtarëve të vet të cilëve, sipas Rregullores së UNMIK-ut 2002/12 në lidhje me themelimin e Agjencionit Kosovar të Mirëbesimit, u është marrë e drejta për menaxhimin e pronës shoqërore. AKK-ja tregoi se transferimi i të drejtave mbi administrim ka dërguar deri te disa restriksione të rrepta nëpër Komunitet si mundësia për të bartur obligimet me qëllim të kryerjes së shërbimeve publike dhe për ndërtimin e shkollave, spitaleve, bibliotekave dhe objekteve tjera publike, pasi që ata nuk kanë pasur më qasje në tokë të mjaftueshme për kryerjen e qëllimeve të veta.

Në fund të takimit Z. Bastagli konfirmoi se nëse një herë Zyra e Këshilltarit Ligjorë (ZKL) dhe Bordi i Drejtorëve të AKM-së aprovojnë draft procedurën e planifikuar nga AKM-ja, ajo procedurë duhet të dërgohet edhe te AKK-ja dhe te të gjitha komunitet.

Hapat e ardhshëm do të jenë se aprovimi që do të vijë nga ZKL dhe Bordi a AKM-së në lidhje me procedurën e përmendur më lartë, AKM-ja do t'i dërgoi AKK-së dhe të gjitha komunave dokumentin parimorë i cili do të nënvizojë procedurat nga të cilat Komunitet mund t'i bëjnë petition AKM-së që të kenë qasje në tokat të cilat janë mbajtur nga ndërmarrjet shoqërore dhe ato publike.

## Bashkëpunimi i AKK-së me Agjencionin e Demokracisë Lokale të Këshillit të Evropës

AKK-ja është ngusht e lidhur me Agjencionin e Demokracisë Lokale (LDA) të Këshillit të Evropës me bazë në Gjilan. LDA-ja është pjesë e rrjetit të Agjencioneve në Evropën JugLindore dhe ata punojnë që t'a inkurajojnë zhvillimin e demokracisë të bazuar në materialet dhe principet e Këshillit të Evropës. AKK, IFES Ltd dhe LDA janë duke diskutuar se si ta rrisin numrin e materialeve burimore të qeverive lokale në Kosovë— në gjuhën Shqipe dhe Serbe. Është shpresuar që me kohë biblioteka e dokumenteve të rëndësishme Evropiane do të formohet—duke filluar me Kartën Evropiane të Vetë qeverisjes Lokale, Kartën Evropiane Urbane si dhe me Kartën Evropiane Shoqërore.

### Hulumtimi mbi Standardet

Njëri ndër projektet e AKK-së që është duke u realizuar është edhe Hulumtimi lidhur me Sa Komunitet e Kosovës i kanë përmbushur Standardet e Përcaktuara nga Komuniteti Ndërkombëtar.

Hulumtimi është duke u bërë në atë mënyrë që një ekip tre anëtarësh ka filluar vizitat në komunat e Kosovës dhe është duke intervistuar strukturat komunale dhe ato të shoqërisë civile lidhur me përmbushjen e Standardeve. Intervistat bëhen me:

1. Përfaqësues politik të Komunës (Kryetari apo Nënkryetari)
2. Përfaqësues të Administratës Komunale (Kryeshefi Ekzekutiv)
3. Përfaqësues të Komuniteteve (Kryetari i Komisionit të Komuniteteve) dhe
4. Përfaqësues të Shoqërisë civile ( OJQ të ndryshme dhe KMLDNI-ja)

Zhvillimi i projektit është duke vazhduar në mënyrën më të mirë të mundshme.

Përfundimi i të gjitha vizitave parashihet që të bëhet në javën e fundit të muajit Mars kurse raporti final lidhur me këtë hulumtim pritet të dalë në fund të muajit Prill.

### Vizita në komunat e Jesenicës dhe Kranjska Gorës në Slloveni

Me datë 21 Janar, në organizim të Asociacionit të Komunave të Kosovës dhe në përkrahje të Fondacionit Kosovar për Shoqëri të Hapur (KFOS), Kryetari i Komunës së Vitisë Z.Musa Misina, Kryetari i Komunës së Shtimes Z.Fehmi Mujota, Kryetari i Komunës së Deçanit Z. Ibrahim Selmanaj dhe Kryetari i Komunës së Klinës, Z. Ramë Manaj e bënë një vizitë në qytetin e Jesenicës dhe Kranjska Gorës në Slloveni, me qëllim të shkëmbimit të përvojave në lidhje me komunat Kosovare dhe ato Sllovene.

Katër kryetarët e komunave u takuan me kryetarin e Komunës së Jesenicës nga i cili morën njohuri në lidhje me sistemin dhe organizimin e pushtetit shtetëror në nivel të shtetit slloven, numrin e komunave, shkallën e zhvillimit të tyre, strukturat vetëqeverisëse dhe funksionimin e tyre, po ashtu ata kanë dëgjuar në veçanti shpjegimin e detajuar në lidhje me çështjet buxhetore, zhvillimin ekonomik të Jesenicës, me problematikën e organizimit dhe funksionimit të shërbimeve publike.

Përveq kryetarit të Jesenicës ata u takuan edhe me kryetarin e Kranjska Gorës, Z. Jure Zherjav.

Me kryetarin e Kranjska Gorës ata kanë biseduar në lidhje me organizimin e shërbimeve publike, koncesionin, investimet në këtë fushë, menaxhimin dhe problemet e vështirësitë. Po ashtu ata kanë thelluar njohuritë nga shpjegimet që i referoheshin planifikimit urban dhe urbanizmit, të hyrave buxhetore dhe burimeve, inkasimit të taksave dhe tatimeve.

Kryetarët e komunave të Kosovës përveç këtyre takimeve kanë vizituar edhe muzeun e qytetit të Jesenicës si dhe Planicën, qendrën e njohur të skijimit në Slloveni.



### Ri-përkthimi i Kartës Evropiane mbi Vetëqeverisjen Lokale

Karta Evropiane e Vetë qeverisjes Lokale ishte e përkthyer edhe në gjuhën shqipe, por pasi që projekti i Agjencionit Evropian për Rindërtim filloi "Mbështetje e Decentralizimit në nivelin Komunal" është bërë studimi i përkthimit të kësaj Karte. Pasi që përkthimi kishte gabime të shumta ai është korrigjuar dhe ripërkthyer nga ana e IFES-it. Përkthimi përveç në gjuhën shqipe është bërë edhe në gjuhën serbe dhe të dy përkthimet e këtij dokumenti gjenden në zyret e Asociacionit të Komunave të Kosovës.

## **AKK-ja në përkrahje të peticionit për pengjet e pagjetura**

Këshilli Koordinues i Asociacioneve Familjare të pengjeve, të të zhdukurve dhe familjeve me viktime të luftës në Kosovë (KKAF) dhe rrjeti i aktivistëve Kosova Action Network (KAN) kanë organizuar një peticion për pengjet e pagjetura të Kosovës. Mbledhja e nënshkrimeve ka filluar më 1 Nëntor 2003 dhe ka zgjatur deri më 1 Shkurt 2004. Grumbullimi i nënshkrimeve është bërë ashtu që peticioni është vendosur në lokale të ndryshme publike anembanë Kosovës si dhe duke shkuar derë më derë nëpër shtëpitë e qytetarëve.

Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK) e ka përkrahur fuqishëm këtë iniciativë. Aktivistët e KKAF-së, KAN-it, por edhe të KMDLNJ-së, UPSUP-së dhe të një numri të konsiderueshëm të organizatave të tjera kanë arritur që të mbledhin mbi 150.000 nënshkrime. Mirëpo, shumica dërmuese e nënshkrimeve janë mbledhur nëpër qytete. Fshatrat kryesisht nuk kanë arritur të përfshihen.

Dihet se shumica e komunave të Kosovës kanë bashkëpunim të ngushtë me udhëheqësit e fshatrave. Kjo ka paraqitur një mundësi shumë të mirë për të mbështetur këtë peticion. Duke u bazuar në bashkëpunimin e ngushtë në mes të komunës dhe udhëheqësve të fshatrave, AKK-ja së bashku me Komuna ka ndihmuar në organizimin e mbledhjes së nënshkrimeve nëpër fshatrat e ndryshme të Kosovës.

## **Vizita e Z. Lutfi Haziri, Kryetarit të KK-së të Gjilanit dhe njëherit Kryetarit të AKK-së në Bruksel**

Kryetari i Komunës së Gjilanit dhe njëherit Kryetari i AKK-së Z. Lutfi Haziri, ishte i ftuar për një vizitë zyrtare në Bruksel më 23 dhe 24 shkurt 2004. Z. Haziri në këtë vizitë ka qenë i ftuar në kapacitetin e Kryetarit të Komunës së Gjilanit. Me këtë rast Z. Haziri më 23 Shkurt pati takim me Z. Stefano Sanino – këshilltarë i Z. Romano Prodit. Gjithashtu, në këtë ditë Z. Haziri takoi edhe Z. Stefan Lehne – Drejtorë për Ballkanin Perëndimorë, Këshilli i Evropës. Po ashtu, Z. Haziri ishte pjesëmarrës në tryezën e rrumbullakët të organizuar nga fondacioni Think Tank-un nga Brukseli. Në këtë takim u shkëmbyen idetë dhe ekperiencat lidhur me iniciativën ndër-kufitare Gjilan-Preshevë– Kumanovë (GjPK) dhe prioritetet e regjionit të Ballkanit perëndimor si dhe për implikimet politiko-ekonomiko-shoqërore të bashkëpunimit ndërkufitar në këtë zonë.

Më 24 shkurt Z. Haziri pati një takim të planifikimit dhe koordinimit të bashkëpunimit ndër-kufitar të GjPK me delagacionin e Këshillit të Evropës në Institutin Lindje-Perëndim si dhe një sesion të shkurtër me Paktin e Stabilitetit në lidhje me projektin GjPK.

Z. Haziri takoi edhe përfaqësuesit e Komunitetit Shqipëtar të cilët punojnë dhe veprojnë në Bruksel.

## **Vizitë Asociacionit të Njësive të Vetëqeverisjes Lokale të Maqedonisë**

Drejtori Ekzekutiv i përcaktuar i AKK-së, Z. Sazan Ibrahimimi qëndroi për një vizitë njëditore në Shkup. Me këtë rast ai vizitoi Asociacionin e Njësive të Vetëqeverisjes Lokale të Maqedonisë (ANJVL) ku u takua me homologun e tij Znj. Dusica Perishiq. Me këtë rast ai u njohtua lidhur me projektet dhe punën që bënë ANJVL si dhe me rolin e këtij asociacioni në Maqedoni.

Njëherit, z. Ibrahimimi njoftoi Znj. Perishiq lidhur me punën dhe aktivitetet e AKK në Kosovë.

U shpreh interesim i dyanshëm për bashkëpunim sa më të ngushtë të Asociacionit të Komunave të Kosovës dhe Asociacionit të Njësive të Vetëqeverisjes lokale të Maqedonisë .


Rr. Isa Kastrati, Nr.113

Tel: 038/ 248 941

Fax: 038/ 248 941

Email:

komunat\_akk@hotmail.com



Statusin e  
Vëzhguesit